




**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHONI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA**



REGISTRI I PËRQITSHMËRJEVE
DOKUMETI
565/n3
DITËSI 19.09.2013
DRAGASH - PRIZREN

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat, më 19.09.2013 dha këtë:

MENDIM JURIDIK

Kur është paraqitur kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit (sipas nenit 192.të KPK), nuk është e nevojshme të merret vendim formal, përpos nëse vendoset të mbahet seancë dëgjimore sipas kushteve të përcaktuara me ligj (paragrafi 3 i nenit 192 të KPK).

I pandehuri dhe mbrojtësi, në situata të tillë, vetëm do të njoftohen me shkrim se nuk janë përbushur kushte ligjore për abrogimin e paraburgimit.

A r s y e t i m

Ligji u ka njojur të drejtën të pandehurit dhe mbrojtësit që në çdo kohë të kërkojnë vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit, d.m.th., të kërkojnë abrogimin e tij, ose të ankohen për kushtet jo të përshtatshme në hapësirat ku i pandehuri e mban paraburgimin (neni 192. par. 3). Kjo dispozitë ligjore po interpretohet në mënyra të ndryshme nëpër gjykatat e Kosovës. Disa gjykata po e trajtojnë si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe çështjen po e adresojnë në Gjykatën Supreme, disa të tjera po marrin

vendime përkitazi me to, me udhëzime për mjetin juridik që mund të përdoret, gjë që e detyroi Gjykatën Supreme të japë këtë mendim juridik.

Në situata të tilla ekzistojnë dy mundësi ligjore: e para, që gjykata ta shqyrtojë kërkesën dhe të mos e miratojë atë, nëse konsideron se ende qëndrojnë arsyet ligjore për paraburgimin dhe për këtë vetëm ta informojë parashtruesin dhe, e dyta, që të mbajë seancë dëgimore, nëse vlerëson se janë përbushur kushtet ligjore për ndërprerjen e paraburgimit.

Nëse konsideron se nuk janë përbushur kushte ligjore për ndërprerjen e paraburgimit, gjykata nuk merr vendim formal, por vetëm e njofton parashtruesin e kërkesës se nuk e ka miratuar kërkesën e tij për ndërprerjen e paraburgimit .

I pandehuri ka përdorur mjetet juridike në dispozicion kur është caktuar, përkatesisht kur është vazhduar paraburgimi dhe vendimi sa i përket paraburgimit ka marr formë të prerë. Po të merrej vendim formal në raste të tilla, atëherë, duke u nisur nga standardi se ndaj çdo vendimi gjyqësor është e lejuar ankesa, kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, të pandehurit do duhej dhënë udhëzimi për përdorimin e mjetit juridik dhe në këtë mënyrë do krijohej një praktikë që ndaj çdo vendimi të tillë të lejohet ankesa, ashtu që do të mund të ndodhte që i pandehuri gjatë të gjithë kohëzgjatjes së procedurës të parashtronte kërkesë pas kërkese, (*nga se ligji ka përdorur shprehjen në “çdo kohë”*) dhe ndaj çdo vendimi që do merrte gjykata ai do përdorte mjetet juridike. Nëse do krijohej një praktikë e tillë, puna e gjykatave në procedurën e paraburgimeve do shumëfishohej, ndërsa Ligji i ka definuar qartë procedurat sa i përket përdorimit të mjeteve juridike. Kjo do të thotë se, kur gjykata çmon se ende qëndrojnë arsyet ligjore për paraburgim, lidhur me kërkesën e të pandehurit apo të mbrojtësit të tij, ajo përgjigjet vetëm me një njoftim.

Kryetari i Gjykatës,
Dr. sc. Fejullah Hasani
